



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0620

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Berisha Construction” SH.P.K kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të Komuna Suhareke në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndertimi i serave - Ritender me numër të prokurimit:624-25-4585-5-2-1, me 01/09/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “Berisha Construction” SH.P.K me nr. 2025/0620, e datës 08/07/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndertimi i serave – Ritender me numër të prokurimit: 624-25-4585-5-2-1.
2. Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Ndertimi i serave - Ritender me numër të prokurimit 624-25-4585-5-2-1 kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Berisha Construction” SH.P.K

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 26/05/2025, Komuna Suhareke në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Ndertimi i serave - Ritender me numër të prokurimit 624-25-4585-5-2-1.

Ndërsa me datën 26/06/2025 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate OE Eltoni Ha SH.P.K. ne vlere totale te ofertës 151,090.00 Euro.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 180,000.00 €

Me 01/07/2025, OE “Berisha Construction” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 08/07/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Berisha Construction” SH.P.K me nr. 0620/2025 lidhur me aktivitetin Ndertimi i serave – Ritender me numër të prokurimit: 624-25-4585-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Berisha Construction” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti kontraktues, me datë 26.06.2025, në platformën e e-prokurimit ka publikuar njoftimin mbi vendimin të AK-së, duke shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik ELTONI HA SH.P.K., ndërsa ofertën tonë e ka kualifikuar si ofertë të pasuksesshme për këtë aktivitet të prokurimit.

Operatori ekonomik Berisha Construction SH.P.K., në përputhje me nenin 10 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), me datë 26.06.2025, përmes e-prokurimit, kërkoi qasje në të gjithë dokumentacionin e ofertës së operatorit të rekomanduar për kontratë, ELTONI HA SH.P.K.. Autoriteti kontraktues ka kthyer përgjigje përmes e-prokurimit, duke njoftuar se qasja mund të mundësohet me datë 30.06.2025.

Zyrtari i prokurimit, me datë 30.06.2025, nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin të operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënien e kontratës, duke arsyetuar se operatori i përmendur ka plotësuar kërkesën për sekret afarist që përfshin të gjithë dokumentet që bëjnë pjesë në nenet 68 dhe 69 të LPP-së. Andaj, ai ka dorëzuar vetëm këto dokumente: vërtetimin e ATK-së dhe gjykatës, deklaratën nën betim, certifikatën e biznesit, certifikatën e TVSH-së, numrin fiskal, listën e çmimeve dhe kërkesën për sekret afarist të ELTONI HA SH.P.K.

Si operator ekonomik, kemi kërkuar që zyrtari i prokurimit të dorëzojë edhe dokumentet që bëjnë pjesë në kapacitetin ekonomik-financiar dhe teknik-profesional, respektivisht “versionin e pastruar”, siç e parashikon neni 11, paragrafi 4 i LPP-së, në rastet kur kemi të bëjmë me sekret afarist, në mënyrë që dokumentet e tilla të vlerësohen dhe analizohen për të përcaktuar nëse ato kanë plotësuar kërkesat dhe dëshmitë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Por, versioni

i tillë nuk është dorëzuar nga zyrtari i përmendur.

Me datë 30.06.2025, kemi dërguar një shkresë përmes e-prokurimit të zyrtari i prokurimit, kërkuar versionin e pastruar sipas nenit 11, paragrafi 4 të LPP-së, por ky version me dokumente nuk është dorëzuar deri tani, dhe ne nuk kemi mundur ta shikojmë dhe analizojmë nëse operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka plotësuar kërkesat e përzgjedhjes/kualifikimit.

Pretendimi ankimor: “Mosdorëzimi i dokumenteve të versionit të pastruar të OE ELTONI HA SH.P.K..”

Aneksi 3 - Kërkesa për Sekret Afarist

Zyra e prokurimit, përkatësisht zyrtari i prokurimit, në rastet kur oferta përmban kërkesën për konfidencialitet, duhet të përgatisë versionin e pastruar të çdo dokumenti sipas nenit 11 të Ligjit për Prokurimin Publik. Ky version i pastruar duhet të përfshijë informacionet që nuk janë sekret afarist dhe ato që janë të klasifikuara si të tilla. Autoriteti kontraktues duhet të bashkëngjisë në ballinën e versionit të pastruar një njoftim që thotë se disa elemente të informatës janë klasifikuar si informata sekrete afariste, dhe versionin i pastruar është një kopje e saktë e origjinalit, pas heqjes së informacionit të tillë.

Autoriteti kontraktues, Komuna e Suharekës, duhet të përgatisë versionin e pastruar të dokumenteve dhe të dorëzojë ato që nuk përmbajnë informacion sekret afarist, ashtu siç kërkohet nga LPP. Kjo nuk është bërë deri më tani, dhe kërkesa për dorëzimin e dokumenteve të pastruara është ende në pritje.

Kërkesa për Zbatimin e LPP-së

Kërkojmë nga zyrtari i prokurimit që të zbatojë në mënyrë të plotë nenin 11, paragrafët 4 dhe 5 të LPP-së dhe të dorëzojë versionin e pastruar të dokumenteve, të cilët përmbajnë të gjithë informacionin autentik dhe origjinal që dëshmon se operatori ekonomik ka plotësuar kërkesat dhe dëshmitë për kapacitetin teknik-profesional dhe ekonomik-financiar.

Si ankues, ne gjithashtu kërkojmë që çdo element që mund të klasifikohet si sekret afarist të mos dorëzohet, por të dorëzohen dokumentet origjinale që dëshmojnë se kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë janë plotësuar, siç është parashikuar në nenin 7, paragrafi 1 të LPP-së: “Autoriteti kontraktues do t’i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.”

Përveç plotësimit të formës standarde të kërkesës për sekret afarist nga OE ELTONI HA SH.P.K., arsyeja e dhënë në këtë kërkesë është gjenerale dhe nuk ofron asnjë fakt, provë apo dëshmi se zbulimi i sekretit afarist mund të dëmtojë seriozisht biznesin e tij. Pra, kërkesa e tillë nuk është dashur të aprovohet nga zyrtari i prokurimit në mungesë të fakteve dhe dëshmive bindëse, siç kërkohet në Rregulloren 001/2022 për Prokurimin Publik, Neni 7, paragrafi 7.6.1.

Shkeljet nga Zyrtari i Prokurimit

Mosdorëzimi i versionit të pastruar nga zyrtari i prokurimit përbën shkelje të rënda sipas Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022, Neni 97, Shkelje të Rënda, Pika c): “Moslejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumentet zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik.”

Kërkesa pranë KRPP-së për Revokimin e Certifikatës së Prokurimit

Në përputhje me Rregulloren për Prokurimin Publik 001/2022, Neni 91, “Inicimi i revokimit të çertifikatës profesionale të prokurimit” dhe Neni 99, “Masat disiplinore për shkeljet e rënda”, do të paraqesim pranë KRPP-së kërkesën për revokimin e çertifikatës së prokurimit publik për zyrtarin e prokurimit, i cili nuk ka dorëzuar versionin e pastruar të dokumenteve të sekretit afarist të operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënien e kontratës.

Zyrtari i prokurimit, përmes aprovimit të kërkesës për rishqyrtim dhe kthimit të aktivitetit të prokurimit në rivlerësim, mund të parandalojë vazhdimin e këtyre shkeljeve të lartpërmendura. Në të kundërt, përveç ankesës në OSHP, do të ndërmerren hapa të tjerë në KRPP dhe instancat e tjera, pasi mosdorëzimi i dokumenteve që dëshmojnë nëse operatori ekonomik ka plotësuar ose jo kërkesat e dosjes së tenderit është shkelje e Ligjit të Prokurimit Publik dhe legjislacionit për prokurimin publik.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 09/07/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0620/2025, ndërsa me datë 21/07/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 0620/2025, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Berisha Construction” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0620 ka vlerësuar si në vijim:

Të gjitha pretendimet ankimore të Operatorëve Ekonomikë (OE) ankues kanë të bëjnë me çështjen e qasjes në dokumente, ku OE kanë parashtruar kërkesën për rishqyrtim pranë Komunës së Suharekës, në përputhje me Nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Kërkesa është bërë për shkak të mosdorëzimit të versionit të pastruar të dokumenteve nga ana e Zyrtarit të Prokurimit po ashtu edhe nr.2025/0620 përmban me pretenimet e njejta ankimore

PERRGJIGJE NDAJ PRETENDIMI 1

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, - Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës

Pretendimi ankimor OE ankues Berisha Construction sh.p.k, në pajtim me Nenin 10 të LPP-së, ka kërkuar përmes e-Prokurimit qasje në dokumentacionin e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë ELTONI HA sh.p.k. Megjithatë, zyrtari i prokurimit nuk ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin, me arsyetimin se OE i përzgjedhur ka kërkuar sekret afarist për të gjitha dokumentet që bëjnë pjesë në nenet 68 dhe 69 të LPP-së. Si rezultat, janë dorëzuar vetëm dokumentet bazë si: vërtetimi nga ATK dhe Gjykata, deklarata nën betim, certifikatat e biznesit

dhe TVSH-së, numri fiskal, lista e çmimeve dhe kërkesa për sekret afarist e ELTONI HA sh.p.k.

Në lidhje me këtë nen Ekspertj shqyrtues thekson se qellimi i këtij neni është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se duhet ti trajtojnë të gjithë operatorët ekonomik në menyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit.

Eksperti shqyrtues sqaron se mos-ofrimi i dokumenteve të kërkuara, duke përfshirë të gjitha dokumentet që i nënshtrohen dispozitave të nenit 68 dhe 69 të Ligjit për Prokurimet Publike (LPP), përbën sekret afarist. Kjo gjendje është në kundërshtim me qellimin e Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, dhe Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës,

Andaj pretendimi ankimor është i bazuar.

PERRGJIGJE NDAJ PRETENDIMI 2

Neni 11 Informatat Sekrete Afariste

Pretendim ankimor “Mosdorëzimi i dokumenteve të versionit të pastruar të OE ELTONI HA sh.p.k”, ku OE ankues ka kërkuar nga zyrtari i prokurimit edhe dokumentet që bëjnë pjesë të Kapaciteti ekonomik-financiar dhe teknike-profesional, respektivisht “versionin e pastruar” siç e rregullon Nenin 11 Paragrafi 4 të LPP-se në rastet kur kemi të bëjmë me sekret afarist në mënyrë që dokumentet në fjalë të vlerësojmë dhe analizojmë se a kanë plotësuar kërkesat dhe dëshmitë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë por version i tillë nuk është dorëzuar nga zyrtari në fjalë. OE ankues sqaron tutje se ka dërguar një shkresë përmes e-prokurimit të zyrtari i prokurimit duke kërkuar versionin e pastruar sipas Nenin 11 Paragrafi 4 të LPP-se por ky version me dokumente nuk duke pa mundësuar që të analizojmë se OE i rekomanduar për kontratë a ka plotësuar kërkesat e përzgjedhjes/kualifikimit.

Eksperti shqyrtues pas analizimit të dokumentacionit sqaron se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, në mosdhënien e qasjes në dokumentacionin e kërkuar, nuk është bazuar në Nenin 11, pika 4 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Neni 7 Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion Rregullorja 001/2022 për Prokurimin Publik versioni I konsoliduar duke e cenuar kështu një të drejtë të garantuar me ligj.

Në këtë rast ZPP nuk ka vepruar në harmoni me nenet:

Neni 7.6.2 Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit menjëherë pas procesit të hapjes së ofertave dhe para publikimit të B58 “Njoftimi mbi vendimin e AK-së”, duhet të përgatitë versionin e pastruar në përputhje me paragrafin 4 të nenit 11 të LPP-së dhe të njoftojë palën. Shih: RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar)

Neni 7.6.3 Zyrtari i Prokurimit sipas kërkesës për qasje në dokumente nga OE (siç përkufizohet në nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.26 të LPP-së), pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK (B58), ofron qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar dhe mban procesverbal, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.

Neni 7.6.5 Jo të gjitha dokumentet e specifikuar nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë në përputhje me nenin 68 dhe 69 të LPP-së, mund të klasifikohen si informata sekrete afariste. Dokumentet e specifikuar sipas nenit 68 e 69 të LPP e të cilat janë publike në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit tjetër përkatës në fuqi, nuk mund të klasifikohen si informata sekrete afariste.

Eksperti shqyrtues mendon se AK-Suhareke ka shkelur edhe Nenin 11 Paragrafin 4 dhe 5 te LPP-se dhe Neni 3. (ii) ku ut te i o t r a t u s u d t i a o ë o a t t e t e r a i n o a t ë e e t e a a r i s t e e m n e n o a t a p a t e i p b h ë ë t o t r i t e r e:

Neni 3. (II) me të cilin parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik

.Në rastin konkret OE I rekomanduar ELTONI HA sh.p.k ka dorzëzuar Kërkesë për sekret afarist në bazë të nenit 68,69 të LPP-se në menyre të pergjishme pas specifikuar se cilat dokumente të konsiderohen sekret afarist.

Pavarsisht kesaj Autoriteti kontrakutes është dashur të përgadis versionin me të gjitha përmbajtjen autentike/origjinale te dokumenteve te cilat dëshmojnë se OE a ka plotësuar kërkesat dhe dëshmitë te kapaciteti teknik-profesional dhe ekonomik-financiar.

Eksperti shqyrtues sqaron se është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues (AK) të sigurojë që pjesët e deklaruara si sekret afarist (jo të gjitha dokumentet sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së) të mos vihen në dispozicion të Operatorëve Ekonomikë të tjerë. Ky proces duhet të realizohet duke respektuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe ligjet e tjera në fuqi.

Për më tepër, AK është i detyruar të përgatisë versionin e pastruar të dokumenteve në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (versioni i konsoliduar), duke siguruar mbrojtjen e informacionit konfidencial dhe respektimin e të drejtave të të gjitha palëve të përfshira në aktivitetin e prokurimit. Në këtë kontekst, lejimi dhe mosneglizhimi i qasjes në dokumentet zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit është i detyrueshëm, kur një qasje e tillë është në përputhje me nenet 10 dhe 11 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Pretendimi ankimor duke u bazuar në dëshmitë e lartë cekura qendon dhe është i bazuar.

PERRGJIGJE NDAJ PRETENDIMI 3

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve

OE ankues nuk ka permendur ndonje pretendim se AK-Suhareke gjate vleresimit nuk ka vepruar ne harmoni me nenin 59 Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve

PERRGJIGJE NDAJ PRETENDIMI 4

Shkeljet nga Zyrtari i Prokurimit

OE anku- BERISHA CONSTRUCTION SH.P.K. në këtë pretendim konstan se mos dorëzimit i versionit te pastruar nga zyrtari i prokurimit bene shkelje te renda sipas Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022, Neni 97 Shkelje te Renda Pika c) Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik ku do t'j drejtohen me kërkesë pranë KRPP-se për Revokimin te Certifikatës se Prokurimit për zyrtarin e prokurimit

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues vetem ka sqaruar , do paraqesim pranë KRPP-se kërkesën për revokimin te certifikatës se prokurimit publik për zyrtari e prokurimit i cili nuk ka dorëzuar versionin e pastruar te dokumenteve te sekretit afarist te OE te rekomanduar për dhënie te kontratës.

KONSTATIM:

Eksperti shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues (AK) -Komuna e Suharekë duhet t'i sigurojë Ankuesit **BERISHA CONSTRUCTION SH.P.K** qasje në versionin e pastruar të dokumenteve dhe të kthejë çështjen për rivlerësim, duke respektuar dispozitat e nenëve të përmendura më lart.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndertimi i serave - Ritender me numër të prokurimit 624-25-4585-5-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Ndertimi i serave - Ritender me numër të prokurimit 624-25-4585-5-2-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - BERISHA CONSTRUCTION SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: